



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura V**

Sesioni vjeshtor

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport**

Mbledhja nr.76

Prishtinë, më 27.12.2016, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,  
KULTURË, RINI DHE SPORT**

**Në mbledhje morën pjesë:** Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Ismajl Kurteshi, Shpejtim Bulliqi dhe Teuta Haxhiu.

**Mungoi** Sërgjan Popoviq, Bekim Haxhiu, Mufera Shinik dhe Shukrije Bytyqi.

**Përfaqësues të ftuar:**

**Përfaqësues të tjerë:**

**Stafi Mbështetës i Komisionit:** Shaip Goxhuli.

**Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.**

**Për këtë mbledhje u propozua ky**

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datës 19.12.2016 dhe 22.12.2016**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2016 dhe orientimet kryesore për vitin 2017;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

### **2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datës 19.12.2016 dhe 22.12.2016;**

Komisioni i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të datës 19.12.2016 dhe atë të 22.12.2016

### **3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2016 dhe orientimet kryesore për vitin 2017;**

Kryetari i Komisionit, Nait Hasani e hapi mbledhjen duke bërë një rezymë të punës dhe aktiviteteve që ky Komision ka kryer. Ai tha se plani i paraparë për punën e Komisionit për vitin 2016 ka qënë mjaftë i ngjeshur dhe dinamik. Hasani përmendi vizitat që ka bërë Komisioni në Universitete, Fakultete, Shkolla si dhe institucione tjera të arsimit. Poashtu u përmenden edhe vizitat, dëgjimet publike për monitorimin e Ligjit për Pjesëmarrje dhe Fuqizim të Rinisë. Hasani përmendi disa nga çështjet që do të diskutohen në mbledhjet e ardhshme të Komisionit për vitin 2017, të cilat përfshijn Raportin e PISA, atë të Kurrikulës, debati për Arsimin.

Ismajl Kurteshi propozoi që Komisioni të ftohet nga MASHT për të marr pjesë në mbledhjet e Kolegjiumit të Drejtorëve të Drejtorive për Arsim, në mënyrë që të shohin nga afër punën dhe angazhimin për ngritjen e cilësisë në arsim. Ai propozoi një plan më aktivitete të cilin mund ta diskutojnë dhe në pikat që i shohin të arsyeshme të përfshihen në planin e përgjithshëm të punës për vitin 2017.

Salih Morina paraqiti propozimin e tij që vizitat në terrën të bëhen në nivel regional, pasi që sipas tij kjo të do të nxiste një pjesëmarrje më aktive të tyre.

Nait Hasani tha se duhet të përfshihet Ligji për Mbrotjen e Gjuhës, dhe të përfshihet dokument-drafti i ofruar nga Instituti Albanologjik, dhe në këtë mënyrë të zbatohet një uniformim i gjuhës standarde nëpër institucione, teatro, televizione, etj.

Teuta Haxhiu propozoi që Komisioni të marr nismë legjislative për Ligjin për Vullnetarizëm. Ajo tha se ka kërkesë që kjo pjesë të ndahet nga Ligji për Rini, sepse në këtë mënyrë do të definoreshin më mirë çështjet që kanë të bëjnë më njohjen e vullnetarizimit si përvojë pune. Më tej ajo shtojë se nëse nuk ka gatishmëri që kjo të inciohet si Komision, atëherë ajo mund ta bëjë inicimin individualisht. Një propozim tjetër i Haxhiut ishte që Drejtorët e Shkollave të mos zgjedhen më nga Kryetarët e Komunave, por të kthehet ashtu siç ka qënë, pra, nga Bordi i Shkollës.

#### **4. Të ndryshme;**

Për këtë pikë nuk pati diskutime

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

***E përgatiti:***

***Njësia për Mbështetjen e Komisionit.***

Kryetari i Komisionit,

-----

Nait Hasani